



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:063914

Datë: 20.04.2022

Numri i dokumentit: 02935945

P.nr.100/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me procesmbajtësen-praktikanten Liridona Bajrami në çështjen penale kundër të pandehurit R. Sh. nga fshati O. Komuna e Vushtrrisë për shkak të veprës penale “Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 par.6 lidhur me par.1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorit të shtetit PP.II.nr.162/22 të dt.11.03.2022, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, më datë **04.04.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit, PP.II.nr.162/22 të dt.11.03.2022, Andaj gjykata konform dispozitës së nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI

R. Sh. nga i ati F. dhe e ëma N. Sh. i vajzërisë B. i lindur me, me vendbanim në fshatin O. Komuna e V. me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

SEPSE: nga periudha e papërcaktuar deri më datën 07.07.2021, në fshatin A. Komuna e V. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, ka marrë shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit dhe ka shmang pagesen, ashtu që ka furnizuar objektin e tij me energji elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuarit KEDS, nga ku është furnizuar me energji elektrike, ashtu që në rrjetin elektrik është kyçur drejtëpërdrejtë, duke anashkaluar njëhësorin elektrik dhe në këtë mënyrë ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është regjistruar,

Nga data 07.07.2021, deri më datën 26.07.2021, në fshatin A. Komuna e Vushtrrisë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, ka marrë shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit dhe ka shmang pagesen, ashtu që ka furnizuar objektin e tij me energji elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuarit KEDS, nga ku është furnizuar me energji elektrike, ashtu që në rrjetin elektrik është kyçur drejtëpërdrejtë, duke anashkaluar njëhësorin elektrik dhe në këtë mënyrë ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është regjistruar.

Nga data 26.07.2021 deri më datën 06.11.2021, në fshatin A. Komuna e V. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, ka marrë shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit dhe ka shmang pagesen, ashtu që ka furnizuar objektin e tij me energji elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuarit KEDS, nga ku është furnizuar me energji elektrike, ashtu që në rrjetin elektrik është kyçur drejtëpërdrejtë, duke anashkaluar njëhësorin elektrik dhe në këtë mënyrë ka shpenzuar energjinë elektrike e cila nuk është regjistruar, duke dëmtuar kështu KEDS – in në shumë prej **406,32 euro**.

-me këtë ka kryer veprën penale: “Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj gjykata–komformë dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 43, 69, 70 dhe nenit 314 par.6 lidhur me par.1 lidhur nenin 77 të KPRK-ës, si dhe bazuar ne nenet 450, 463, 495 të KPP-së i shqipton.

DËNIM ME GJOBË

Me të cilën të pandehurit R. Sh. i caktohet dënimi me gjobë në shumën prej **200€ (dyqind euro)**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. . Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shëndrrohet në dënim me burgim, duke i caktuar të akzuarit, për çdo 20 Euro (njëzetë euro), të dënimit me gjobë nga 1 (një) ditë burgim.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të dëmit, palës së dëmtuar KEDS të ia paguaj shumën e dëmit në vlerë prej **406.32 euro**.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor te paguaje shumën prej **30 (tridhjetë) euro**.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovice ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.162/22 të dt.11.03.2022, kundër të pandehurit R.Sh. nga fshati O. Komuna e V. për shkak të veprës penale “Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 par.6 lidhur me par.1, lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të pandehurit të jep Urdhrin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë se shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës se Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri, ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në tre (3) vjet, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave

nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si kallëzimi penal i datës 26.01.2022, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit i datës 07.07.2021, foto – dokumentacion në shtojcë prej 2 fotografive, raporti i kalkulimit të rikthimit të humbjeve i datës 29.07.2021, Fatura DMIHP ... e datës 29.07.2021, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit i datës 26.07.2021, foto – dokumentacion në shtojcë prej 7 fotografive, raporti i kalkulimit të rikthimit të humbjeve i datës 11.08.2021, Fatura DMIHP... e datës 11.08.2021, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit i datës 06.11.2021, foto – dokumentacion në shtojcë prej 7 fotografive, Fatura DMIHP... e datës 15.11.2021, raporti i kalkulimit të rikthimit të humbjeve i datës 12.11.2021, janë prova të besueshme me të cilat vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, për këtë edhe i shqipton urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mori parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, meqë rast vepra është kryer me dashje nga ana e të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë ne rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë të kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsoi dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par.2 nën par.2.6 të KPPK-së. Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar KEDS gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par.2 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë në kuptim të nenit 365 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.100/22 të datës 04.04.2022

Procesmbajtësja-praktikantja
Liridona Bajrami

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afatë prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.